

Procesverbal
Mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Skrapar
Mbajtur më datë 26.06.2025

Ora e hapjes së mbledhjes sipas njoftimit 10:30, vendi i mbajtjes së mbledhjes : Salla e mbledhjeve e Këshillit Bashkiak Skrapar, Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë.

Listëprezenca e Këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.

1. ALMA KADIASI
2. ARJAN HASA
3. ALBANA HOXHA
4. EDMOND KALEMI
5. ELSA PETRITAJ
6. ERAUD ZAIMI m
7. ENVER ÇAKA
8. FIKRET TELHA
9. LIRI NUHELLARI
10. MIMOZA HYSAJ
11. MIMOZA ZYLYFTARI m
12. MYQERRET HEBIBASI m
13. PËLLUMB GURI
14. SKERDILAJT JAUPLLARI
15. VALBONA GROPA m

Sekretare e Këshillit deklaroi kuorumin prej 11 Këshilltarësh.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema.Përfaqësues të Administratës, të cilët kanë hartuar projekt-vendimet që do të merren në shqyrtim

Kryetare Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes duke kaluar në pikën 1, miratimi i rendit të ditës sipas njoftimit të bërë me nr.18 prot. të datës 19.06.2025.

Kryetare e Këshillit u drejtoi pyetjen nëse ka pyetje, diskutime propozime në lidhje me rendin e ditës.

Këshilltarët shprehin dakortësi me rendin e ditës të njoftuar.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.
Ora 09:30

Vota pro: 9, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Mimoza Hysaj, Pellumb Guri.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 2 e rendit të ditës , Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Konstituimit të Këshillit Bashkiak, datë 28.05.2025

Kryetare Këshillit u drejtoi pyetjen këshilltarëve nëse ka dikush për të shtuar diçka në lidhje me procesverbalin i cili u është vënë në dispozicion çdo këshilltari së bashku me materialet e mbledhjes së radhës.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme . Ora 09:35

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pellumb Guri,

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 3 deklarimet e konfliktit të interesave

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka konflikt interesi nga këshilltarët për çështjet që do të merren në shqyrtim.

Për çështjet që do të merren në shqyrtim asnjë ngaanëtarë e këshilltarët nuk ka shprehur konflikt interesi.

Pika 4 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2025”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projekt-vendimit.

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili pyet që për këtë muaj nuk ka as hyrje as dalje?

Me leje fjalën e merr znj.Teuta Hysenbelliu e cila shpreh se është e njëjta listë si muaji Prill.

Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.
Ora 09:45

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi,Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pellumb Guri.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 5 e rendit të ditës “Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Dritan Musabelli”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se të dyja rastet e Ndihmës Ekonomike kanë vërtet nevojë dhe keni bërë shumë mirë që i keni futur në rendin e ditës. Unë mendoj që dhe Rajmondit dhe Dritanit po e patë të arsyeshme t'ju jepet edhe më shumë.

Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 09:55

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi,Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 6 e rendit të ditës “Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Rajmond Kapllani”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh nqs do kishte mundësi edhe për më shumë më mirë do ishte, ai vazhdon kurimin jashtë plus që ka qenë edhe punonjës i bashkisë.

Me leje fjalën e merr znj, Teuta Hysenbelliu e cila shpreh se ka marrë një ndihmë financiare dhe kjo është me vlerën 100.000 lekë në krahsim me të tjerët është më shumë.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se më mirë është ta kalojmë dy herë pagesën.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:05

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalem, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 7 e rendit të ditës “Për miratimin e vendosjes së bustit të Patriotit “Mestan Ujaniku” në mjediset e lulishtes pranë kinemasë së qytetit Lagjia “Çlirimi” Çorovodë”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projekt-vendimit.

Me leje fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema e cila prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh se duhet të çohemi në këmbë për këto dy figura të shquara të Skraparit. Çfarë të flasësh për Mestan Ujanikun i cili luftoi dhe në fund e vranë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Teha i cili shprehet se kjo duhet të shtyhet si seancë ose të ishte bërë edhe takimi me grupin e interesit. Nuk dimë asgjë për firmëtar dhe Komandant i Çetës Plakë, klikojmë në google shkruajnë siç u do qefi. Unë më parë mendoj nëse duhet të kishte kaluar në bazë të ligjit, duhet të kaloj në komision. Që të vendosësh dy buste unë mendoj se duhet të njihemi dhe me vlerat dhe me biografinë që dhe ne të jemi të qartë. Pse duhet të flasim pa argumenta, të hasemi me njëri tjetrin ku një thotë ka luftuar, tjetri thotë ska luftuar. Duhet të bëhen takime edhe referendume në gjithë Skraparin.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpjegon se termi takim me grup interesi bëhet kur këshilli i bashkisë do vendosi një tarifë apo një taksë që vinë pa fond, grup të caktuar që kanë biznese. Do bëhet një rrugë bëhet takim me komunitetin.

Me leje fjalën e merr z. Fukret Teha i cili shpreh se këto kanë shumë vlerë se janë buste që do vendosen me dekata, se nesër ngrihem dhe unë dhe them, më vendosni bust se jam burri i mirë.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se shpjegova vetëm se çfarë do të thotë grup interesi dmth nuk kam çfarë të bëj me grup interesi sepse i vetmi refuzim ose ankesë më vjen vetëm nga ajo ç'ka kanë dërguar, Komiteti ose Organizata e Veteranëve ka njëgjysmë faqe për Mestan Ujanikun dhe thotë që ka këto merita, është vlerësuar nga ky nga ky dhe këtu të mbaroi se s'kemi nevojë për bust. Askush nuk e mohon faktin që Xhelal Koprëncka ka qenë i vetmi delegat në shpalljen e Pavarsisë. A përbëjnë këto dy figura , ose veprimtaria e tyre, a ka arsyeshëm apo mjaftueshëm argument për tu nderuar nga Skrapari apo jo? Kjo është pyetja. Unë nuk po i bëj as Qytetar Nderi as Nder i Kombit. Unë kam një kërkesë që këto dy figura të nderohen, dhe është nderi juaj ti nderoni këta.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se nuk them se nuk jam dakort me vendosjen e busteve, por të vendosen në bazë të meritave dhe argumentave të sakta. Ti the që kam bërë takime me familjarë dhe shoqatën, ata detyrimisht do jenë dakort, unë mendoj se duhet të jetë i gjithë këshilli, nuk kemi asnjë procedurë si kanë kaluar, si i kanë vlerësuar dhe kush i ka vlerësuar.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se ne duhet të marim miratimin e këshillit në parim, nuk është se do ti vendosim nesër sepse është një procedurë shumë e gjatë. Në të gjithë këtë procedurë do të konsultojmë me urbanistë, as nuk e kam caktuar asgjë thjesht po hapim rrugën.

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh se në dijenin e tij Mestan Ujaniku në ditën që u arrestua u burgos, këtu thon stop këta. Regjimi asaj kohe e shfrytëzoi për interesat e veta dhe në fund e vrau se ai luftoi për demokracinë. Për mua duhet të jetë nderi i Skrapalinjëve.

Me leje fjalën e merr.Enver Naska i cili shpreh se Organizata e Veteranëve dhe pasardhësve të LANÇ të Popullit Shqiptar, Nderi Kombit nuk është një shoqatë do kudo, por ajo mbron idealet e atyre që dhanë më të shtrenjtën për Atdheun dhanë jetën e tyre. Ne jemi në mbrojtje të asaj historie. Për sa i përket Xhelal Behut e vetmja akt është që ish deputet i asaj krahine dhe ishte zyrtar, të gjitha të tjerat pastaj. Skrapari ka burra të tjerë që e meritojnë, ka burra të tjerë që kanë dhënë gjakun/jetën, kanë punuar për Shqipërinë.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili bën një pyetje drejtuar Enver Naskës ju merreni shumë me anën e errët të Xhelal Koprënckës që është e pafaktuar , unë do merrem me ato që janë fakte dhe fakti është që Xhelal Koprëncka ka qenë një ndër 83 firmëtarët e Aktit të Pavarsisë. Pyetja ime ishte kjo a ka akt më madhor se sa të jesh firmëtar i Pavarsisë për një reagim që për çfarë është Skrapari, për çfarë përfaqëson Skrapari dhe jo vetëm që ka qenë ndër 83 firmëtarët e Pavarsisë por dhe është zgjedhur dhe një ndër 80 senatorët , në atë periudhë kur ka qenë në dyshim ekzistenca e shtetit shqiptar. Ju bëni një letër ku thoni nuk i lajmëroi ai ata të Tomorricës se donte të ishte i vetëm, po 83 firmëtar ishin se sdo shkonte e gjithë Tomorrica.

Me leje fjalën e merr.Enver Naska i cili shpreh po tërë këto jetë njerëzish që mungojnë.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se kto nuk janë të faktuara.

Me leje fjalën e merr.Enver Naska janë nga historia, gjithëcka është e shkruar.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema dhe thotë që kënga që thoni ju është një bejte, që mund ta ngrej kushdo. Kam dhe një pyetje tjetër se ju shpreheni që në emër të 600-të keni bërë ndonjë mbledhje? Ju me këta të 600-të që keni dalë në këtë konkluzion apo është mendimi juaj?

Me leje fjalën e merr.Enver Naska Komiteti i Veteranëve funksionon një statut dhe në bazën e këtij statuti e themi. Ne nuk kemi ndonjë gjë tjetër, mbrojmë gjakun dhe ato sakrifica që janë bërë nga veteranët e LANÇ- it. Ne jemi autorizuar për mbrojtjen e simboleve edhe për mbrojtjen e këtyre figurave.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema në letrën tuaj ju e pranoni kontributin e tyre dhe thoni e vlerësuar.

Me leje fjalën e merr z. Taip Çela i cili shpreh se ka të tjerë burra se kush, shikojni ka histori Skrapari.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se me gjithë respektin që ka për zotërinjtë dhe për Organizatën dhe për çdo anëtarë të Organizatës unë jam dakort por me fakte, komente janë të lira mund të bëji kushdo. Sipas fakteve ky është Mestan Ujaniku dhe ky Xhelal Koprëncka.

Me leje fjalën e merr z. Pëllumb Guri i cili shpreh se ta hedhim në vota mos ta zgjasim shumë se këta të dy e meritojnë.

Me leje fjalën e merr z.Arjan Hasa i cili drejton pyetjen se në çdo datë 5 Maj ju vizitoni varrezat e Dëshmorëve. A ka qenë ndonjë nga balli krah jush?

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se nuk i kam vënë re në krahun tim kan qenë këta dy zotërinjtë Enver Naska, Taip Çela 5 Maji dhe 5 Shtatori.

Me leje fjalën e merr z.Arjan Hasa i cili shpreh se të dy këta duhen mbështetur duhen vlerësuar për çfarë bëjnë.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se ua kam thënë publikisht vlersimin tim për atë çka bëjnë, skam lënë rast pa i përmendur përpjekjet që ata bëjnë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shprehet se mendon se duhet një vendim më i plotë për këtë vendim madhor që duhet të marim.

Me leje fjalën e merr z. Enver Caka i cili shpreh se ka një mendim mos ta bëjmë siç bëmë me vendimin e librit, por të sjellim materialin e plotë. Me kanë marrë në telefon dy veta dhe më kanë thënë kur do ti vini bustet. Nuk kemi vetëm këto dy figura ka plotë të tjerë. Biles dhe bustet janë bërë janë dhe në muze.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se bustet nuk janë bërë por ai që ndodhet në muze është një objekt muzeal.

Me leje fjalën e merr znj.Liri Naço e cila shpreh se për sa i përket figurës së Xhelal Koprëncës me Këshillin e Qarkut më ka rënë rasti të shkoj në disa aktivitete të veteranëve dhe më bëri

përshtypje në një muze në Sinj të Pirogosh figura e Xhelal Koprenckës ishte i pasqyruar atje me gjithë aktivitetin e vetë, dhe vetë veteranët e Beratit e vlerësuan shumë, dhe mua më erdhi mirë që Xhelal Koprencka ishte në atë vend dhe në atë muze atje në Shpirag të Beratit, dhe besoj se ky është vlerësim.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:40

Vota pro: 9, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: 2: Enver Caka ; Fikret Telha

Pika 8 e rendit të ditës “Për miratimin e vendosjes së bustit të Patriotit ‘Xhelal Koprëncka’ në mjediset e lulishtes Lagjia “ 5 Shtatori” Çorovodë”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Pellumb Guri i cili shpreh se të flasësh për Xhelalin që ka qenë i vetmi Skrapali që na ka përfaqësuar i mbulon të tëra gjërat, është nder i Skraparit, ka ngritur flamurin në emër të Skrapalinjëve.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:50

Vota pro: 9, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: 2: Enver Caka, Fikret Telha

Pika 9 e rendit të ditës “Për miratimin e project-dokumentit të pare të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projekt-vendimit

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili prezantoi projekt-vendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje e merr fjalën z. Edmond Kalemi i cili shpreh se do të dijë për buxhetin e Këshillit. Çfarë u bë me buxhetin e vjetshëm?

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se këto janë ndryshime që do hasen gjatë rrugës mos u lodh. Na thuaj për buxhetin e Këshillit ke parashikuar ndonjë gjë apo aq sa ka qenë?

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili shpreh se buxheti Këshillit bëhet në fazën e fundit kur ju bëni kërkesën. Unë mendoj se ju duhet të bëni kërkesë për çdo lloj gjëje që ju nevojitet, dhe unë e shoh që ju duhen mikrofona, printera, kompjutera. Do vendosim gjatë kohës, gjatë procedurës. Buxheti i vjetshëm çfarë u shpenzua, u shpenzua, diferenca ka kaluar për këtë vit.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se të kalosh 5 miliard lekë dhe mos të relizosh kërkesat e Këshillit.

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili shpreh se jam dakort që të pajiseni me laptop secili të vetën dhe letra nuk shpenzojmë shumë dhe as kohë nuk harxhohet.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se e vetmja gjë që unë nuk jam dakort është Ndërmarrja e Shërbimeve Publike siç e kam thënë punon pa asnjë llogaridhënie në Këshill, ndërton atje ku i do qefi, punon atje ku i do qefi se sa shpenzon se sa merr dhe se çka bëhet nuk e dimë. Çdo punim që bëhet të kalohet në këshill, të bëhet një preventiv, u bë kjo rrugë u harxhuan kaq ngelën kaq që dhe për vete të jetë i mbrojtur.

Me leje fjalën e merr znj. Liri Nuhellari e cila shpreh se për sa i përket turizimit është menduar ndonjë investim, sepse të shpejta e Pirogoshit shkojnë shumë turistë mirëpo është skandal, të paktën të menaxhohet të mbahet pastër ose të bëhet një rrugë e mirë.

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo ke shumë të drejtë, ajo që ngre dhe Fikreti shpeshherë në mbledhje s'më tingëllon aspak mirë sepse tani 105,110 milion lekë të reja që ka Ndërmarrja, i ka për të realizuar shërbimet e pastrim/gjellbërimit. Aty pastaj është mungesë vëmendje për të pastruar aty ku duhet, nuk janë organizuar mirë. Për pastrim/gjellbërimit harxhohet goxha, çështja është që ju si Këshill mund të kërkonit të raportoj drejtori i Ndërmarrjes.

Me leje fjalën e merr z. Pëllumb Guri i cili shpreh për të parë na duhet për Këshillin kamera, mikrofona, laptopa të bëjmë kërkesën dhe çfarë do bëhet me udhëtimin.

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili shpreh se është shumë dakort për që të investohet për Këshillin që ju të jeni me komod për mbledhjet, dhe një investim tjetër që ne kemi menduar është dhe këndi i lojrave për fëmijë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se mirë është menduar për këndin e lojrave por s'ka fëmijë. Është dhe diçka tjetër shqetësuese që e kam ngritur dhe më parë, për rafting që ka ngritur Zamo kaq të paaftë jemi ne që të vi ai të vendosi trarin, mos kalojmë dot ne për të shkuar në lumë. As mos të paguajë asnjë taksë asgjë, ku e ka marrë këtë leje ai?

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili shpreh se kur nuk ka të zot këtu për këtë punë.

Me leje fjalën e merr z. Liri Nuhellari e cila shpreh se ka të zot, licencën e ka marr Arbër Gogo por i pengojnë.

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo shumë mirë ta konkurojnë me çmime më të ulta.

Me leje fjalënn e merr z. Fikret Telha i pengon ai i turizmit se çunat po punojnë me çmime më të ulta po kanë konflikte me atë, sepse është kryetar i shoqatës së rafting dhe i pengon me polici. Të shkojnë të gjithë ata turiste dhe ai mos paguaji kokërr leku.

Me leje fjalën e mer zj.Liri Nuhellari ashtu e ka gjetur klauzolen ai e ka bërë shoqëri jofitimprurëse.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:00

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 10 e rendit të ditës "Për miratimin e transferimit nga zëri i invenstimeve nga të ardhurat e Bashkisë, objekti:Rikonstruksioni i segmenteve rrugore në Njësinë Administrative, në objektin : Asfaltim i rrugës nga Lapidari deri në fshatin Kakrukë, Bashkia Skrapar bashkëfinancim me Këshillin e Qarkut Berat".

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili pyet se është pjesa lartë e fshatit që do përfshihet dhe vlera ishte 29 milion të vjetra ?

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se pjesa e sipërme e fshatit do përfshihet dhe se 25 milion do ti paguajmë ne dhe 100 milion do ti paguaji Këshilli i Qarkut.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:05

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Të ndryshme

Nuk ka

Kryetare e Këshillit e deklaroi përfundimin e mbledhjes .

Sekretare Këshillit Bashkiak: Xheni Çela



Kryetare Këshillit Bashkiak: Elsa Petritaj




Këshilltarët që firmosin procesverbalin:

1. Alma Kadiasi



2. Fikret Telha



3. Skerdilajt Jaupllari

